

VENDIM
Nr.30, datë 2.5.2006

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH PËR NISJEN E
PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 114, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Miratohet Raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për “Ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me kërkesën e një grupi deputetësh për “Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Theodhori Sollaku, në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)